



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2019:100750  
Datë: 26.04.2022  
Numri i dokumentit: 02954735

C.nr.734/18

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Mirjeta Shala, në çështjen juridike kontestuese të paditësve M.K. na P., Rr..., H.H. nga Gj., Rr..., T.D. nga Gj., Rr..., H.D. nga Gj., Rr... dhe H.H. nga P., Rr... të përfaqësuar nga avokati Ferid Gjokolli avokat, kundër të paditurit R.B. nga Gj., Rr..., me objekt kontesti, Dorëzim i banesës, jashtë seance me datë 26 prill 2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPREHET procedura në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes të paditëses H.D. nga Gj., rr ...

II. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët ta zgjidhin trashëgiminë apo kur kujdestari i pasurisë trashëgimore e marrin për sipër procedurën, apo kur gjykata i thërret ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.

A r s y e t i m

Paditësit M.K. na P., rr..., H.H. nga Gj., Rr..., T.D. nga Gj., Rr..., H.D. nga Gj., Rr... dhe H.H. nga P., Rr... të përfaqësuar nga avokati Ferid Gjokolli, kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datën 12.11.2018, kundër të R.B. nga Gj., Rr..., me objekt kontesti Dorëzimin e Banesës.

Pasi informacionit te pakonfirmuar se paditësja H.D., ka vdekur, gjykata me kërkesën e datës 23.02.2022 i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, dhe KRM "Qabrati", për të konstatuar faktin e vdekjes së paditëses duke kërkuar nga të njëjtat që brenda mundësive edhe dërgimin e certifikatës së vdekjes, në rast se e njëjta ka vdekur.

Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, me parashtrësën e datës 01.04.2022 e ka njoftuar gjykatën se H.D. e lindur ne Gj., me adresën në Rr..., ka vdekur dhe e njëjta është regjistruar në RTH të vdekjes, duke paraqitur edhe certifikatën e vdekjes, si dëshmi se e njëjta ka vdekur. Një fakt të

tillë e ka konfirmuar edhe KRM "Qabrati" me shkresën e dorëzuar përmes e-mailit zyrtare të datës 29.03.2022.

Nga Certifikatë e vdekjes me nr. rendor 710 me nr. të referencës 2/2021RV/2001, me nr. Ser 10491141, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, me datë 29.03.2022, vërtetohet fakti se paditësja H.D. nga Gj. ka vdekur me datë 30.12.2021

Andaj, gjykata faktike në shkresat e lëndës nuk posedon aktvendim të trashëgimisë, sipas të cilit do të vërtetohej se trashëgimia ndaj tani të ndjerës H.D. , ka përfunduar në formë të prerë, atëherë në kuptim të nenit 95, lidhur me nenin 277 nën parag. a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008 të shpallur në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.734/18, datë 26 prill 2022

Gj y q t a r j a  
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.